



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 275/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala edhe Ferit Osmani anetare, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave mbi rruge publike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë kështu që subjektit politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 1000(njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 17 10 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 16 tetor 2013 në Rrugën Ilir Konushveci në Prishtinës anëtarë të AAK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit të këtij subjekti politik Visar Ballovcit mbi rruge publike, ku me këtë veprim sipas parashtrësimit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, nën 33 pika b) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Parashtrësi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografën si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.20, ora 14:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga AAK, në të cilën theksohet se vendosja e banerit të kandidatit të AAK për asamblenë komunale në Prishtinë mbi rrugë publike nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-se. AAK pretendon se vendosja e banerit mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të paidentifikuar, ose mbështetës të këtij kandidati të cilët janë laik me legjislacionin zgjedhor. AAK konfirmon që me të pranuar njoftimin për dukjen e banerit të kandidatit të AAK mbi rruge publike, struktura menaxhuese e fushatës, konkretisht Shtabi Zgjedhor për komunën e Prishtinës, ka bërë largimin e këtij baneri.

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë AAK, ka dërguar fotot për të cilat thuhet se kanë larguar reklamat kontestuese.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se baneri i kandidatit për asamble komunale në Prishtinë nga radhët e AAK-së, është i vendosur mbi rrugët publik i cili veprim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik AAK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se baneri i kandidatit për asamble komunale në Prishtinë nga radhët e këtij subjekti politik ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e banerit . Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke e larguar menjëherë banerin nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se nga ana e subjektit politik AAK-së është shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për asamble të komunale nga AAK-së është i vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik AAK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 275/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*